

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA DURRES

Sheshi "Liria", tel & fax +355 52 22 23 10 e-mail: info@durres.gov.al

Nr 5257 Prot

Durrës më, 10/7/2015

KONTRATË PËR PUNË PUBLIKE

“Rruge mbi kanalin kullues K-192 Plazh, loti 1”

Nr. References se Kontrates: BD.PH.15.15

Lidhur ndërmjet palëve

Bashkise Durrës “Autoriteti Kontraktor”

Dhe

BEQIRI+SHKELQIMI 07+SPEKTRI “Kontraktuesi”

KONTRATË

Rruge mbi kanalën kullues K-192 Plazh, loti 1

Nr i referencës BD.PKP.15.15

Kjo marrëveshje (Kontratë) nënshkruhet sot më datë 10 . 7 . 2015 Durrës ndërmjet dy palëve :

“Autoriteti Kontraktor” **Bashkia Durrës**
Adresa : Sheshi “Iliria”, Qyteti Durrës
Tel /fax: 052 22 23 10
NIPT : K42006501R
Përfaqësuar nga Kryetari Bashkise z. Vangjush **DAKO**

Dhe

“Kontraktuesi” **BEQIRI+SHKELQIMI 07+ SPEKTRI**
Adresa : Lagjja 15 Tetori, Rr. Todi Shkurta, pallati 10 katesh me nr-47/2,
kati i dyte, FIER
Tel /Fax: 0695683450
NIPT : J98624801V+K68121808W+J62903555F
Përfaqësuar nga Administratoret Z. Neim BEQIRAJ, Shkelqim KAPLLANAJ, Robert YZEIRAJ

Neni 1 - Baza ligjore

Kontrata mbështetet në ligjin nr 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, KPK dhe KVK në dokumentat e tenderit, ligji nr. 8652 date 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore dhe në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë. Kontrata do të qeveriset dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2- Përbërja e kontratës

2.1 Kontrata do të përbëhet nga dokumentet e mëposhtëme dhe dokumentat të tjera të tenderit të datës 11.05.2015 duke përfshirë KPK dhe KVK në dokumentat e tenderit

1. Sigurimi i kontratës në shumën 10 % të vlerës së kontratës në formën e garancisë lëshuar nga shoqëri sigurimi .

2. Oferta teknike dhe ekonomike paraqitur nga kontraktuesi në tender dhe të pranuar nga Autoriteti Kontraktor , me specifikimet teknike, projekti, preventivin me çmimet për njësi dhe vlerën sipas Aneks-kontratës.

2.2 Prokure e posacme, Deklarate Bashkepunimi:

Bashkangjitur Prokure e posacme, Deklarate Bashkepunimi.

2.3 Fjalët dhe shprehjet në këtë kontratë do të kenë të njëjtin kuptim ashtu siç përcaktohen në Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta të kontratës në dokumentat e tenderit.

Neni 3 – Objekti i kontratës

3.1 Janë të gjitha Punet për “Rruge mbi kanalin kullues K-192 Plazh, loti 1” (sipas skicave, projektit) të cilat kontraktori do ti siguroje sipas kushteve të kontratës.

3.2 Kantieri i ndërtimit do të jetë ne objektet e percaktuara nga Kontraktori.

Neni 4 – Çmimi i kontratës

4.1 Çmimi që i paguhet kontraktuesit për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të kontratës është 61’352’140 (gjashtedhjetenje milion e treqindpesedhjetedy mije e njeqindedyzet) leke pa Tvsh dhe me vleftë me Tvsh 73’622’568 (shtatedhjet e tre milion e gjashteqind e njezet e dy mije e peseqind e gjashtedhjet e tete) lekë.

4.2 Kontrata është Kontrate me Çmim Njesie te bazuar ne çmimet e njesise te shprehura ne Preventivin per Njesi.

Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e realizuar me tarifën në preventivin në Njësi për secilin zë punimesh.

Neni 5 –Mënyra dhe afatet e Pagesës

5.1 Pagesa do te behet me transferte bankare brenda 30 diteve kalendarike nga realizimi i punimeve (data e vertetuar nga Autoriteti Kontraktor se punet jane mbaruar).

5.2 Pagesa do te behet sipas situacionit/situacioneve mujore te puneve te verifikuara dhe te konfirmuara nga Drejtuesi i Projektit duke dorezuar situacion dhe faturen tatimore.

5.3 Te gjitha te drejtat dhe detyrimet me Bashkine Durres do te kryhen nga BEQIRI, sipas prokures (bashkangjitur)

5.4 Monedha e pagesës do të jetë monedha shqiptare (lekë) .

5.5 Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

Neni 6 - Grafiku i realizimit të punimeve

6.1 Grafiku i realizimit te punimeve i paraqitur nga kontraktuesi dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktor, kerkohet te siguroje realizimin e te gjitha puneve brenda **90 diteve** (afati prej 90 diteve, zbatohet sipas ligjit nr. 8402 date 10.09.1998 dhe udhëzimeve te nxjerra ne zbatim te këtij ligji me ndryshimet përkatëse).

Neni 7 – Sigurimi teknik

7.1 Kontraktuesi do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjithë aktiviteteve në kantier.

Neni 8 – Detyrat e kontraktorit.

8.1 Kontraktori do të kryejë dhe mbarojë punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit dhe të pranuar sipas Anex-kontrates bashkangjitur.

8.2 Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollimin e cilësisë së punimeve dhe cilësisë së materialeve gjatë zbatimit të kontratës . Ai duhet të njoftojë Drejtuesin e Projektit dhe Autoritetin Kontraktor per rrethana specifike që mund të ndikojnë negativisht në punë për realizimin e objektit të kontratës.

8.3 Sa herë që të jepet njoftimi për difekte, kontraktori duhet ti korrigojë ato brenda kohëzgjatjes së parashikuar në njoftim .

8.4 Kontraktori duhet ti paraqese drejtuesit te projektit nje program plan dhe te pergatise sipas aprovimeve te tij raportimet per ecurine e punimeve, kontrollin e cilesise dhe situacionet per punimet e kryera.

8.5 Kontraktori duhet te zbatoje : kushtet teknike te zbatimit ne fuqi

Neni 9- Drejtuesi i Projektit

9.1 Drejtuesi i Projektit është personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor, qe eshte përgjegjës për administrimin e kontratës per Autoritetin Kontraktor.

9.2 Drejtuesi i projektit ne se zbulon se punimet nuk jane perfunduar plotesisht do ti jape udhезime me shkrim kontraktorit qe specifikojne zerat e punimeve ose aktivitetet qe duhen perfunduar .

9.3 Drejtuesi i projektit duhet te kontrolloje punimet e egzekutuara nga kontraktori dhe duhet te vertetoj per Autoritetin Kontraktor shumen qe duhet ti paguhet kontraktorit në bazë të Situacionit / situacioneve të marra nga kontraktuesi .

Neni 10 – Korrigjimi i difekteve

10.1 Nëse Kontraktori nuk ka korrigjuar një difekt brenda kohës së specifikuar në njoftim, Drejtuesi i projektit do të llogarisë koston e korrigjimit të difektit dhe kjo shumë do të mbahet nga pagesa që duhet bërë kontraktuesit derisa difekti të korrigjohet .

Dështimi për të korrigjuar difektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate per arsye mospermbushje ne favor te Autoritetit Kontraktor.

Neni 11- Mbarimi dhe marrja persiper e puneve.

11.1 Kontraktori pas perfundimit te puneve i paraqet drejtuesit te projektit dokumentacionin dhe llogaritjet perfundimtare te punimeve te kryera dhe i kerkon atij te leshoje nje çertifikate per mbarimin e punimeve dhe drejtuesi i projektit do ta beje kete sapa te vendosi se punimet jane mbaruar plotesisht.

11.2 Drejtuesi i projektit në rast se gjatë kolaudimit zbulon Pune te pa perfunduara plotesisht ose defekte ne Punime të cilat janë pasojë e punës jo cilësore të Kontraktuesit, do ti paraqesi atij me shkrim dhe do kërkojë kryerjen dhe riparimin e tyre brenda një afati të arsyeshëm.

Neni 12 – Rreziqet e Kontraktuesit

12.1 Nga data e hyrjes në kantier deri në përfundim të punimeve Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për dëmtim personal , vdekje, humbje ose dëmtim të pasurisë .

Neni 13- Siguracioni

13.1 Minimumi i kërkuar për tu mbuluar nga sigurimet sipas ligjeve në fuqi janë:

- a. Sigurimi për demtime ose humbje te puneve dhe materialeve
- b. Per demtime ose humbje te pajisjeve
- c. Per demtime ose humbje te pasurise pervec puneve, Materialeve dhe Pajisjeve
- d. Per demtim personal ose vdekje te personave ne kantier.

Neni 14 – Likuidimi i demeve

14.1 Tarifa ditore për demet e likujdueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve përtej afatit **90** ditor do të jetë 4/1000 e vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por jo më pak se 25 përqind e vlerës së saj.

14.2 Kamata e shperblimit për demet e shkaktuara si rezultat i vonesës në berjen e pagesës përlogaritët nga data e fillimit të vonesës që është 30 dite nga data e vertetuar për Autoriteti Kontraktor se punët janë mbaruar.

Neni 15 – Forca madhore

15.1 Kontraktuesi do të çlirohet nga përgjegjësia për moszbatimin e detyrimeve kontraktuale që vijnë si rezultat i forcës madhore.

15.2 Nëse ndodh një situatë e tillë kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë me shkrim Autoritetin Kontraktor . Sipas rastit të veprimit të këtij fenomeni palët me marrëveshje e mirëkuptim përcaktojnë kushtet dhe afatet e reja praktikisht të arsyeshme për zbatimin e detyrimeve të kontratës.

Neni 16 – Zgjidhja e kontratës

16.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse :

a) Kontraktori dështon në kryerjen e punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,

b) Kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër sipas kësaj kontrate.

16.2 Autoriteti kontraktor do të japë kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe të japë kontraktorit 15 ditë që të ndreqë mosplotësimin .

16.3 Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e perfunduara brenda Autoritetit Kontraktor do të behen pronë e Autoritetit Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim të kushteve të saj.

Neni 17 – Sigurimi i kontratës

17.1 Shuma e sigurimit të kontratës prej 10 % të vlerës së kontratës do të paguhet Autoritetit Kontraktor si kompesim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktorit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

17.2 Sigurimi i kontratës do të kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes në dorezim të punimeve.

17.3 Garancia e difekteve do të jetë 5% e vlerës së kontratës, që do të mbahet Sipërmarrësit mbi vlerën totale nga situacioni përfundimtar si garanci për cilësinë e punimeve, shumë e cila do të paguhet mbas përfundimit të këtij afati.

Garancia për mbulimin të difekteve, që mund të lindin gjatë shfrytezimit të objektit, nga ana e Kontraktuesit është **2 vjet**.

Neni 18 – Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

18.1 Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura në lidhje me këtë kontratë me mirëkuptim dhe negociata midis tyre.

18.2 Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, do ti drejtohen Gjykatës së rrethit Gjyqësor Durrës dhe problemet do të zgjidhen sipas procedurave juridike në fuqi dhe legjislacionit të Republikës së Shqipërisë .

Neni 19- Dispozita të fundit

Kjo kontratë hartohet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet nga përfaqësuesit e të dy palëve në shtate kopje, 1 (një) për Kontraktuesin dhe 6 (gjashte) për Autoritetin Kontraktor.

Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Autoriteti Kontraktor

Bashkia Durrës

Emri dhe firma e Përfaqësuesit
Vangjush **DAKO**
Kryetar i Bashkise

Vula:




Kontraktuesi

BEQIRI+SHKELQIMI 07+ SPEKTRI

Neim Beqiraj
Emri dhe firma e Përfaqësuesve

Neim **BEQIRAJ**



Shkelqim **KAPLLANAJ**

Robert **YZEIRAJ**

Administrator te shoqërive
Vulat:



ANEKS- KONTRATE

“Rruge mbi kanalin kullues K-192 Plazh, loti 1”

Nr. References se Kontrates: BD.PH.15.15

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj: **Bashkangjitur**

Specifikimet Teknike te Materialeve: **Bashkangjitur**

GRAFIKU I REALIZIMIT

Afati i perfundimit te punimeve eshte 90 dite kalendarike (afati prej **90** diteve, zbatohet sipas ligjit nr. 8402 date 10.09.1998 dhe udhezimeve te nxjerra ne zbatim te ketij ligji me ndryshimet perkatëse).

GARANCIA

Garancia per mbulimin te difekteve, qe mund te lindin gjate shfrytezimit te objektit, nga ana e kontraktuesit eshte 2 vjet.

PREVENTIV PUNIMESH

OBJEKTI: Rruge mbi kanalin kullues K-192 Plazh, loti 1

Nr	Nr.AN	ZERAT E PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	ÇMIMI	VLERA
I	Punime kanalizimi nen rotonden e ures se Dajlanit					
1	3.2	Prerje bime te vogla Ø ÷10cm me makineri	m ²	192	50	9,600
2	3.90/b	Germim dheu kanal prezence uji b>2m, b>3.5 per tuba b/a Ø1500	m ³	1626	300	487,800
3	3.90/b	Germim dheu kanal prezence uji h>3.5 per tuba b/a Ø1500	m ³	310	300	93,000
4	3.90/b	Germim dheu kanal prezence uji per tuba b/a Ø400	m ³	405	300	121,500
5	3.158/(5a+2a)	Transport dheu dale nga germimet deri ne 7km	m ³	2000	300	600,000
6	An	Heqje uji me moto-pompe me dalje Ø100mm gjate kryerjes se punimeve te tubi Ø1500 ne pusta	op	85	600	51,000

7	An 164/1a	Shtrese me cakull mbeturina kave, nen tubat Ø1500 e Ø1000	m ³	208	1100	228,800
8	3.378	Mbushje me zhavor mbi tub Ø1500 e Ø1000	m ³	835	1100	918,500
9	2.56	FV. Tub betoni Ø1500 te kub	ml	128	12000	1,536,000
10	2.558	FV. Tub betoni Ø1000 te kub (nen hekurudhe 2 cif)	ml	48	11000	528,000
11	3.An/2t	FV. Tuba te brinjezuar PESN8 Ø400	ml	100	8000	800,000
12	An	Pastrim i kolektorit ekzistues Ø1500 i bllokuar 80-85%, me sonde dhe i tubit Ø400 qe kalon nen rruge	ml	70	500	35,000
13	2.584	Ndertim puseta kub 2x2x(1.5÷2), prezence uji per tuba Ø1500	cope	5	35000	175,000
14	2.575	Ndertim puseta kub 1x1x(1.5÷2), me kapak betoni	cope	3	30000	90,000
15	3.484	Shtrese ballasi per trasene e hekurudhes	m ³	80	3000	240,000
16	An	Heqje dhe rivendosje e trareve dhe shinave te hekurudhes	ml	48	6000	288,000
17	3.294	Plotesimi me aksesore pjastra etj, te shinave	kg	199	3000	597,000
SHUMA I						6,799,200
II Punime prishje						
1	2.426/5	Prishje betoni ura ekzist, mure betoni ,pasazhe betoni	m ³	100	500	50,000
2	2.426/5	Prishje mure me blloqe	m ³	80	500	40,000
3	3.6	Shkulje peme Ø >76, h>15m	cope	6	4000	24,000
3	An	Spostim shtylle elektrike betoni te tens. Ulet + betonimi i bazamentit	cope	9	20000	180,000
4	3.158/(5a+2a)	Transport materiali dale nga prishjet deri ne 7km	m ³	200	300	60,000
SHUMA II						354,000
III Punime kanalizimi te K.U.B ,K.U.Z mbi kanalim e hapur						
5	3.90/a	Germim dheu kanal prezence uji b>2m, shkarkim mbi mjet	m ³	11300	300	3,390,000
6	3.158/(5a+2a)	Transport dheu dale nga germimet e kanalit te hapur deri ne 7km	m ³	11300	300	3,390,000
7	An 164/1a	Mbushje me gure e çakull gurore deri ne nivelin e bazes se tubave	m ³	2147	1100	2,361,700
	3.240	Shtrese beton i t= 15cm nen tubat e betonit	m ³	203	7000	1,421,000
8	2.560	F.V tuba B/a Ø 1500 me gote	ml	520	12000	6,240,000

9	2.559	F.V tuba B/a Ø 1200 me gote	ml	380	11000	4,180,000
10	An 164/1a	Mbushje me gure e çakull gurore deri ne nivelin e kasonetes	m ³	8050	1100	8,855,000
11	2.584	Puseta kontrolli 2x2x(1.5x2.5) me zgare hekuri Ø 12 me kapak gize Ø 80 cm	cope	19	35000	665,000
12	An20	Pusete kuz 0.8x0.8x1.5 me kapak metalik	cope	38	20000	760,000
13	An 22/1	Pusete shimbledhese 0.4x0.4x1 me zgare	cope	76	7000	532,000
14	3An /1t	F.v tub PESN 8 Ø 315 per K.U.Z	ml	150	3000	450,000
15	An	F.v tub PESN 8 Ø 250 per K.U.B	ml	1800	1800	3,240,000
16	An	F.v tub PESN 8 Ø 250 per K.U.Z lidhje me familjaret	ml	250	1800	450,000
17	3.25/b	Germim per tuba PESN 8 me krah	m ³	1775	400	710,000
SHUMA III						36,644,700
IV	Punime ne rruge					
18	3.17/a	Germime per sistemimin e kasonetes	m ³	720	300	216,000
19	3.211	Shtrese çakulli t=20cm	m ²	6300	200	1,260,000
20	3.208	Shtrese çakulli mbeturine kave t=10cm	m ²	6300	100	630,000
21	3.212/b	Shtrese stabilizanti t=10cm	m ²	5750	150	862,500
22	3.229/2	Shtrese binderi t=6cm	m ²	4850	750	3,637,500
23	3.233/1	Shtrese asfalti t=4cm	m ²	4850	700	3,395,000
24	3.240	Shtrese betoni kunete C15/20 t=12cm	m ³	108	8000	864,000
25	3.238	Shtrese betoni nen bordure t=10cm	m ³	65	7000	455,000
26	3.617/1	F.V bordure 15x30	ml	1858	600	1,114,800
27	An	Heqje uji me moto-pompe me dalje Ø100mm gjate kryerjes se punimeve te betonimt dhe shtrirjes se tubave	op	350	600	210,000
SHUMA IV						12,644,800
V	Punime ne trotuare					
28	3.45/1	Germim dheu per sistemim trotuari	m ³	500	300	150,000
29	3.211	Mbushje me cakull gurore t=20cm + rulim	m ²	2500	200	500,000
30	3.240	Beton C15/20 trotuare	m ³	250	8000	2,000,000
31	2.166	F.v hekur Ø 4 20x20	kg	5000	100	500,000
32	3.616	F.v bordure parafabrikat 12x25	ml	1597	600	958,200
33	3.619/a	F.V bordure betoni per pemet 6x20	ml	500	500	250,000
SHUMA V						4,358,200
VI	Punime elektrike					
34	3An/PP	F.V puseta plastike 40x40x40 me kapak te forte RIC 1084+186	cope	37	2000	74,000

35	3.654/1	F.V tub plastik flesibel d=80 me dy veshje	ml	942	120	113,040
36	A 2,a-99	F.V percjelles bakri i zhveshur per tokezim Cu 25m2	ml	985	200	197,000
37	2.262/4	Betonim shtylle C18/20	m ³	11	8000	88,000
38	3.182/a	Shtrese rere 80cm	m ²	90	400	36,000
39	3.45/1	Germim kanali ne toke te zakonshme me krah per shtrirje tubi elektrik	m ³	144	300	43,200
		SHUMA VI				551,240
		SHUMA I-VI				61,352,140
		TVSH 20%				12,270,428
		TOTALI				73,622,568

Autoriteti Kontraktor

Kontraktuesi

Bashkia Durres

BEQIRI+SHKELQIMI 07+ SPEKTRI

Emri dhe firma e Përfaqësuesit
Vangjush DAKO
Kryetar i Bashkise

Neim Beqiraj
Emri dhe firma e Përfaqësuesve

Neim BEQIRAJ

Vula:




Përfaqësuar nga...
Robert YZEIRAJ

Përfaqësuar me autorizimin...
Administrator te shoqërive
Vulat.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE VLORE
NOTER KADRI BILALI



Nr. 770 i rep.
Nr. 419 i kol

DEKLARATE BASHKEPUNIMI
PER BASHKIM TE PERKOHSHEM TE OPERATORVE
(JOIN VENTURE)

Sot me daten 10.05.2015, para meje noterit Kadri Bilali u paraqiten personalisht palet e me poshtme:

A. SH. P. K. "BEQIRI" e perfaqesuar prej administratorit te saj Z. NEIM BEQIRAJ, me qender e seli ne qytetin Fier, me Nr. NIPT J98624801V, me nr. leternjoftimi 032216273.

B. SH. P. K. "SHKELQIMI 07" e perfaqesuar prej administratorit te saj Z. SHKELQIM KAPLLANAJ, me qender e seli ne qytetin Ballsh, me Nr. NIPT K68121808W, me nr. leternjoftimi G60422139D.

C. SH. P. K. "SPEKTRI" e perfaqesuar prej administratorit te saj Z. ROBERT YZEIRAJ, me qender e seli ne qytetin Fier, me Nr. NIPT J62903555F, me nr. leternjoftimi 027705561.

Rame dakort te lidhim kete Akt-Marveshje (Join Venture) per objektin e prokurimit elektronik: Rruge mbi kanal in kullues K-192 Plazh, loti I qe zvillon BASHKIA DURRES me daten 11.05.2015

Ne rast shtytje te dates se prokurimit, Akt Marrveshja eshte vlefshme ne cdo kohe, qe do te zhvillohet prokurimi per kete objekt.

Punimet do te kryen ne raportin:

A - 43.3 % Firma "BEQIRI" SH.P. K do te kryhen zerave te preventivit si dhe vlerat me poshte:

I		Punime kanalizimi nen rotonden e ures se Dajlanit	VLERA
SHUMA I			6 799 200
II		Punime prishje	
SHUMA II			354 000
III		Punime kanalizimi te K.U.B ,K.U.Z mbi kanal in e hapur	
5	3.90/a	Germimi dheu kanal prezence uji $b > 2m$, shakarkim mbi mjet	3390000
6	3.158/ (5a+2a)	Transport dheu dale nga germimet e kanalit te hapur deri ne 7km	3390000
7	An 164/1a	Mbushje me gure e cakull gurore deri ne nivelin e bazes se tubave	2361700
	3.24	Shtrese beton i $t = 15cm$ nen tubat e betonit	1421000
10	An 164/1a	Mbushje me gure e cakull gurore deri ne nivelin e kasonetes	8855000
SHUMA III			19 417 700

Vlera qe i perket "BEQIRI SH. P. K." eshte VLERA - 26570900 (njezetgj ashtemiljone pesqindshatdhjemijenetqinde) leke pa TVSH

B - 46.4% Firma "SHKELQIMI 07" SH.P. K do te kryhen zerave te preventivit si dhe vlerat me poshte;

III	Punime kanalizimi te K.U.B ,K.U.Z mbi kanal in e hapur		VLERA
8	2.56	F.V tuba B/a Ø 1500 me gote	6240000
9	2.559	F.V tuba B/a Ø 1200 me gote	4180000
13	An 22/1	Pusete shimbledhese 0.4x0.4x1 me zgare	532000
14	3An /1t	F.v tub PESN 8 Ø 315 per K.U.Z	450000
15	An	F.v tub PESN 8 Ø 250 per K.U.B	3240000
16	An	F.v tub PESN 8 Ø 250 per K.U.Z lidhje me familjaret	450000
17	3.25/b	Germim per tuba PESN 8 me krah	710000
SHUMA III			15802000
IV Punime ne rruge			
SHUMA IV			12644800

Vlera qe i perket " SHKELQIMI 07 SH. P. K. " eshte VLERA - 28446800 (njezetetetmiljone katerqindedyzetegjashtemijetetqinde) leke pa TVSH

C - 10.3 % Firma "SPEKTRI" SH.P. K do te kryhen zerave te preventivit si dhe vlerat me poshte;

III	Punime kanalizimi te K.U.B ,K.U.Z mbi kanal in e hapur		VLERA
11	2.584	Puseta kontrolli 2x2x(1.5x2.5) me zgare hekuri Ø 12 me kapak gize Ø 80 cm	665000
12	An20	Pusete kuz 0.8x0.8x1.5 me kapak metalik	760000
SHUMA III			1425000
V	Punime ne trotuare		
SHUMA V			4358200
VI	Punime elektrike		
SHUMA VI			551240

Vlera qe i perket " SPEKTRI SH. P. K. " eshte VLERA - 6334440 (Gjashtemiljone treqindtridhjetkatermijekaterqinddyzete) leke pa TVSH

Investimi per kryerjen e punimeve dhe ndarja e fitimit, qe do te rezultoi ne perfundim te punimeve te kryera, do behet ne pjese perkatesisht sipas punimeve te kryera nga secila firem.

Secila SH. P. K. merr persiper te gjitha pergjegjesite dhe detyrimet perpara entit prokurues, si veç e veç ashtu edhe bashkerisht, si persa i perket cilesise se punimeve, afatit te kryerjes tyre dhe çdo pergjegjesi tjeter te ligjshme, qe do te rrjedh nga kontrata e siper marrjes ne baze te nenit 431 te K. C.


Firma "BEQIRI" SHPK. do te jete partnerja e autorizuar per te mbajtur pergjegjesite dhe per te marre instruksione per vete dhe ne emer te partnerve te ndermarrjes se perbashket, qe kane lidhur kete Deklarate. Marrveshje -Bashkepunimi (Join Venture).

Join Venture (deklarata e bashkepunimit), mbasi lexohet, nenshkruhet nga palet me vullnet te lire dhe, une noteri, e vertetoj sipas ligjit 7629 date 01. 06. 1994, e ndryshimeve te me voneshme.


"BEQIRI" SH. P. K.
ADMINISTRATORI
Z.NEIM BEQIRAJ




"SHKELQIMI 07" SHPK
ADMINISTRATORI
Z.SHKELQIM KAPLLANAJ



"SPEKTRI" SHPK
ADMINISTRATORI
Z. ROBERT YZEIRAJ




NOTERI
KADRI BILALI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE VLORE
NOTER KADRI BILALI

Nr. 771 i rep.

Nr. 920 i kol.



PROKURE E POSACME

Sot me daten 10.05.2015 para meje noterit Kadri Bilali u paraqite personalisht i perfaqesuari:

A. SH. P. K. "SHKELQIMI 07" e perfaqesuar prej administratorit te saj Z. SHKELQIM KAPLLANAJ, me qender e seli ne qytetin Ballsh, me Nr. NIPT K68121808W, me nr.leternjoftimi G60422139D.

B. SH. P. K. "SPEKTRI" e perfaqesuar prej administratorit te saj Z. ROBERT YZEIRAJ, me qender e seli ne Fier, me Nr. NIPT J62903555F, me nr.leternjoftimi 027705561.

Te perfaqesuarit ne mbeshtetje te nenit 70 e vijim te K.C. kerkon redaktimin e procures posacme si me poshte:

Autorizojme dhe caktojme si perfaqesues te posacem Z. NEIM BEQIRAJ administrator I "BEQIRI" SH.P.K. qe te me pefaqesoje ne tenderin, qe do te zhvillohet ne daten 11.05.2015 nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Durres me Objekt: Rruge mbi kanal in kullues K-192 Plazh, loti 1

Pala perfaqesuese ka te drejten e perfaqesimit ne tenderin, qe do te zhvillohet dhe ne se del fituese ka te drejten e lidhjes se kontrates se sipermarrjes per ndermarrjen e perbashket te operatorve te me siperm, sipas percaktimeve qe jane bere ne Akt-Marrveshjen (Join enture) te lidhur sebashku midis nesh.

Te gjitha veprimet e kryra prej perfaqesuesit tim Z. NEIM BEQIRAJ, te percaktuar prej meje me siper do ti konsideroj si te kryera prej vete meje dhe nuk do te kem asnji prendim ne te ardhmen, pra me kete rast, qe nga ky moment, marre persiper te gjitha detyrimet ligjore dhe financiare te rrjedhura prej veprimeve te tij, brenda tagrave te dhena me siper atij prej meje.

I perfaqesuari, mbasi e degjoi prokuren te lexuar me ze te larte e nenshkroi ate me vullnet te lire ne pranin time dhe une noteri e vertetoj sipas nenit 70 e vijim te K.C. dhe ne baze te ligjit 7829 date 01. 06. 1994 e ndryshimeve te mevoneshme.

TE PEFAQESUARIT

"SHKELQIMI 07" SHPK "SPEKTRI" SH. P. K.
ADMINISTRATORET
Z. SHKELQIM KAPLLANAJ Z. ROBERT YZEIRAJ

NOTERI
KADRI BILALI

